

URDHËR
Nr. 9, datë 30.12.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës publike”; pika 7/c dhe pika 9/f, e vendimit nr. 436, datë 26.6.2024, “Për krijimin, organizimin e funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin/Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionit/Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Për bashkëpunimin e ndërsjellë në luftën kundër korrupsionit”, tek z. Insidor Rexhepi, drejtor i përgjithshëm i Antikorrupsionit.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Antikorrupsionit, z. Insidor Rexhepi, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT PËR ADMINISTRATËN
PUBLIKE DHE ANTIKORRUPSIONIN
Adea Pirdeni